



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R D H Ë R

Nr. 60, datë 3.5.2023

P Ë R

**RREGULLAT PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË ANKIMIT
PRANË AGJENCISË PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE,
PËRBËRJEN E TIJ, KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE DHE PROCEDURËN
E SHQYRTIMIT TË ANKIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”,

U R D H Ë R O J:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky urdhër rregullon mënyrën e ngritjes, përbërjen, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Ankimit pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve të subjekteve të inspektimit kundër gjobave të vendosura ndaj tyre, në zbatim të pikës 3, të nenit 56, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, si dhe procedurën e shqyrtimit të ankimit.
2. Në këtë urdhër termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “**Agjencia**”, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, që funksionon në bazë të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;
 - b) “**Komisioni**”, Komisioni i Ankimit pranë Agjencisë, i parashikuar në nenin 57, të ligjit nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”, dhe që është përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve të subjekteve të inspektimit kundër gjobave të vendosura ndaj tyre, në zbatim të pikës 3, të nenit 56, të të njëjtit ligj;
 - c) “**Ligji**”, ligji nr.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”;
 - ç) “**Ankim**”, ankimi i subjekteve të inspektimit kundër gjobave të vendosura ndaj tyre, në zbatim të pikës 3, të nenit 56, të ligjit;

- d) **“Ankues”**, nëpunësi publik, titullari i institucionit të administratës shtetërore ose vetë ky institucion, ndaj të cilit është vendosur gjobë dhe që ushtron të drejtën e ankimit sipas nenit 57, të ligjit;
- dh) **“Gjobë”**, sanksioni i vendosur nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, në bazë të pikës 3, të nenit 56, të ligjit;
- e) **“Inspektor”**, punonjësi i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje që ushtron detyrat e inspektimit sipas kreut X, të ligjit.

II. MËNYRA E NGRITJES SË KOMISIONIT, PËRBËRJA, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË TIJ

1. Komisioni të ngrihet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe të ketë në përbërje tre anëtarë nga radhët e punonjësve të saj, me formimin arsimor-profesional përkatës.
2. Drejtori i Përgjithshëm, nëpërmjet urdhrit për ngritjen e Komisionit, mund të ngarkojë Komisionin me shqyrtimin në vijimësi të ankimeve që paraqiten pranë Agjencisë ose mund ta ngrejë Komisionin *ad hoc* për shqyrtimin e secilit ankim individual.
3. Nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit:
 - a) Drejtori i Përgjithshëm;
 - b) inspektorët, pavarësisht nëse kanë marrë pjesë ose jo në procedurën e inspektimit konkret, objekt ankimi;
 - c) punonjësit e tjerë që kanë marrë pjesë apo kanë bashkëpunuar me inspektorët në procedurën e inspektimit konkret, objekt ankimi.
4. Krahas rasteve të parashikuara në pikën 3, të këtij kreu, kur anëtari i Komisionit vlerëson se është në kushtet e konfliktit të interesit sipas kuptimit të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ai është i detyruar t’ia komunikojë faktin drejtorit të Përgjithshëm.
5. Nëse drejtori i Përgjithshëm konstaton ekzistencën e konfliktit të interesit, ai të caktojë me urdhër një punonjës tjetër për të ushtruar detyrën e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e atij ankimi individual.

III. PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

1. Ankimet të shqyrtohen sipas radhës së paraqitjes së tyre pranë Agjencisë.

2. Për zhvillimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit të zbatohen rregullat dhe afatet e parashikuara në kreun II, të pjesës së gjashtë, të Kodit të Procedurave Administrative.
3. Komisioni, gjatë shqyrtimit në themel të ankimit, të analizojë, duke u nisur nga objekti dhe arsyetimi i ankimit, rregullshmërinë e procedurës së inspektimit, dhe/ose të procedurës ose veprimeve administrative të zhvilluar nga ankuesi, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, legjislacionin në fuqi për inspektimin ose legjislacionin e posaçëm në bazë të të cilit zhvillon veprimtarinë institucioni i administratës shtetërore.
4. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni, brenda afatit të përcaktuar në nenin 140 të Kodit të Procedurave Administrative, të marrë vendim për:
 - a) pranimin e ankimit dhe shfuqizimin e gjobës;
 - b) rrëzimin e ankimit.
5. Vendimi i Komisionit duhet të jetë i arsyetuar, në përputhje me parashikimet e neneve 100 dhe 139, të Kodit të Procedurave Administrative.
6. Në rast pranimi të ankimit për shfuqizimin e gjobës, sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të këtij kreu, Komisioni t’ia përcjellë vendimin e tij drejtorit të Përgjithshëm, i cili duhet të nxjerrë brenda 5 (pesë) ditëve urdhrin për zbatimin e vendimit duke shfuqizuar gjobën.
7. Ngarkohet Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 1904/1
DATË 8 . 5 . 2023

AGJENCISË PËR DIALOG DHE
BASHKËQEVERISJE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

Engjell Agaci

